REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 346, Datë 06.11.2026

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR MIRATIMIN E "METODOLOGJISË TEKNIKE DHE FINANCIARE TË NDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE TË PËRFITIMEVE FINANCIARE BRENDA KOMUNITETEVE TË ENERGJISË SË RINOVUESHME, FORMAT DHE MËNYRAT E NDËRVEPRIMIT ME OPERATORËT E RRJETIT DHE TARIFAT E REGJIMIT TË RRJETIT, SI DHE KUFIZIMET PËRKATËSE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*"; nenit 21, pika 6 të ligjit nr. 24/2023 "*Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme*"; Udhëzimit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 4, datë 29.06.2026 "*Për komunitetet e energjisë së rinovueshme*", si dhe neneve 15 dhe 26 të "*Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*", miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 06.11.2026, pasi shqyrtoi relacionin nr. 3492 prot., datë 05.11.2026 të përgatitur nga Grupi i Punës të ngritur me Urdhrin e Kryetarit të ERE-s nr. 134, datë 18.08.2026, "*Mbi fillimin e procedurës administrative për miratimin e "Metodologjisë teknike dhe financiare të ndarjes së energjisë elektrike dhe të përfitimeve financiare brenda Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme, format dhe mënyrat e ndërveprimit me operatorët e rrjetit dhe tarifat e regjimit të rrjetit, si dhe kufizimet përkatëse*".

Konstatoi se:

- Ligji nr. 24/2023 "*Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme*" dhe udhëzimi i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 4, datë 29.06.2026 "*Për komunitetet e energjisë së rinovueshme*", parashikojnë kuadrin për funksionimin e Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme.
- Projekt-metodologjia përcakton mënyrën e ndarjes së energjisë elektrike të prodhuar nga njësitë e komunitetit ndërmjet anëtarëve të tij, trajtimin e energjisë së tepërt dhe ndarjen e përfitimeve financiare.
- Projekt-akti parashikon tri metoda të ndarjes së energjisë: fikse, sipas përqindjeve të paracaktuara; dinamike, sipas konsumit të matur në të njëjtin interval; dhe hibride, që kombinon dy metodat.
- Ndarja bazohet në të dhënat e matjes të konfirmuara nga operatori përkatës i rrjetit dhe kryhet brenda të njëjtit interval kohor, pa njohur për asnjë anëtar, energji të ndarë më të madhe se konsumi i tij në atë interval.
- Projekt-metodologjia përcakton përgjegjësitë e operatorit të rrjetit për llogaritjen dhe përcjelljen e rezultateve të ndarjes dhe përgjegjësitë e furnizuesit për pasqyrimin e energjisë së përfituar nga komuniteti në faturën individuale.
- Për energjinë e ndarë parashikohet zbatimi i tarifave të përdorimit të rrjetit të miratuara nga ERE, sipas nivelit të tensionit dhe shërbimeve të përdorura, pa aplikuar dy herë të njëjtën tarifë për të njëjtin shërbim dhe të njëjtën sasi energjie.
- Energjia e pandarë evidentohet veçmas; kur shitet ose kompensohet, përfitimi financiar ndahet sipas mënyrës së përcaktuar paraprakisht nga komuniteti dhe kushteve të zbatueshme.
- Projekt-akti rregullon korrigjimin e matjeve dhe faturimit, pasqyrimin e kompensimit, si dhe përmbylljen e llogaritjeve kur anëtari ndryshon furnizuesin, duke shmangur mbivendosjen e sasive.

- Projekt-metodologjia përcakton ndërveprimin ndërmjet komuniteteve, operatorëve të rrjetit dhe furnizuesve, si dhe trajtimin e çështjeve të zbatimit sipas akteve të ERE-s dhe legjislacionit në fuqi.
- Përpara miratimit, projekt-metodologjia do t'i nënshtrohet konsultimit me palët e interesuara, përfshirë operatorët e rrjetit, furnizuesit dhe përfaqësuesit e Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën administrative për miratimin e "*Metodologjisë teknike dhe financiare të ndarjes së energjisë elektrike dhe të përfitimeve financiare brenda komuniteteve të energjisë së rinovueshme, format dhe mënyrat e ndërveprimit me operatorët e rrjetit, dhe tarifat e regjimit të rrjetit, si dhe kufizimet përkatëse*", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Projekt-metodologjia t'i nënshtrohet procedurës së konsultimit dhe shqyrtimit me palët e interesuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e ERE-s për miratimin e akteve rregullatore.

3. Ngarkohet Grupi i Punës për ndjekjen e procedurës, publikimin e projekt-aktit, administrimin dhe shqyrtimin e komenteve dhe organizimin e seancave dëgjimore sipas nevojës, si dhe përgatitjen e materialit për shqyrtimin përfundimtar nga bordi i ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s Nr. 346, Datë 06.11.2026

Projekt-Metodologjia teknike dhe financiare e ndarjes së energjisë brenda komuniteteve të energjisë së rinovueshme, format dhe mënyrat e ndërveprimit me operatorët e rrjetit, dhe tarifat e regjimit të rrjetit, si dhe kufizimet përkatëse

Neni 1
Qëllimi dhe fusha e zbatimit

Kjo metodologji përcakton mënyrën e ndarjes së energjisë elektrike të prodhuar nga njësitë përbërëse të komunitetit të energjisë së rinovueshme, në vijim KER, ndërmjet anëtarëve të tij si dhe mënyrën e trajtimit të energjisë së tepërt dhe ndarjes së përfitimeve financiare që rrjedhin prej saj.
Kjo metodologji përcakton metodat e ndarjes fikse, dinamike dhe hibride të energjisë elektrike, mënyrën e llogaritjes dhe pasqyrimit të saj, procedurat e ndërveprimit ndërmjet KER-it, operatorit përkatës të rrjetit dhe furnizuesve, si dhe zbatimin e tarifave të përdorimit të rrjetit dhe kufizimeve përkatëse.
Kjo metodologji mbështetet në ligjin nr. 24/2023 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", në udhëzimin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 4, datë 29.6.2026 "Për komunitetet e energjisë së rinovueshme", si dhe në Direktivën (BE) 2018/2001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 11.12.2018, mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme (RED II), e ndryshuar me Direktivën (BE) 2023/2413.

Neni 2

Përkufizime

1. Për qëllime të kësaj metodologjie, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Interval kohor i ndarjes" është periudha kohore e njëjtë për të cilën krahasohen të dhënat e prodhimit dhe të konsumit të energjisë elektrike dhe kryhet llogaritja e ndarjes ndërmjet anëtarëve të KER-it.

b) "Konsumi i matur" është sasia e energjisë elektrike të konsumuar nga një anëtar i KER-it gjatë një intervali kohor të ndarjes, e regjistruar nga sistemi i matjes dhe e konfirmuar nga operatori i rrjetit.

c) "Ndarja fikse" është metoda e ndarjes së energjisë elektrike sipas përqindjeve të paracaktuara për secilin anëtar të KER-it, të regjistruara dhe të konfirmuara nga operatori i rrjetit.

d) "Ndarja dinamike" është metoda e ndarjes së energjisë elektrike ndërmjet anëtarëve të KER-it në përpjesëtim me konsumin e matur të secilit anëtar gjatë të njëjtit interval kohor.

e) "Ndarja hibride" është metoda e ndarjes së energjisë elektrike që kombinon ndarjen sipas përqindjeve të paracaktuara me ndarjen në përpjesëtim me konsumin e matur të anëtarëve të KER-it.

f) "Periudha e faturimit" është periudha kohore për të cilën llogariten dhe pasqyrohen në faturë sasitë e energjisë elektrike të konsumuar, të ndarë, të furnizuar dhe të kompensuar.

2. Termat, përkufizimet e të cilëve nuk renditen në pikën 1 të këtij neni, kanë kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 24/2023 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", në Udhëzimin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 4, datë 29.6.2026 "Për komunitetet e energjsë së rinovueshme" si dhe në Direktivën (BE) 2018/2001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 11.12.2018, mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme (RED II), e ndryshuar me Direktivën (BE) 2023/2413.

Neni 3

Parimet e ndarjes

Ndarja llogaritet mbi të dhënat e matjes të kontrolluara dhe të konfirmuara nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në vijim OSSH. Prodhimi i disponueshëm për ndarje dhe konsumi i anëtarëve krahasohen brenda të njëjtit interval kohor. Asnjë anëtari nuk i njihet si energji e konsumuar përmes ndarjes një sasi më e madhe sesa konsumi i tij në atë interval. Llogaritja duhet të jetë e qartë dhe e kontrollueshme nga anëtarët. Mënyra dhe përqindjet e ndarjes zbatohen vetëm për periudhat pas regjistrimit dhe konfirmimit të tyre pranë operatorit të rrjetit, pa ndryshuar rezultatet e periudhave të mëparshme. Për të njëjtën sasi energjie nuk zbatohet dy herë e njëjta tarifë e përdorimit të rrjetit.

Neni 4

Energjia që ndahet

Për ndarje merret energjia e prodhuar nga nga njësitë e prodhimit të KER-it dhe e disponueshme për këtë qëllim, sipas matjeve të konfirmuara nga opratori përkatës i rrjetit. Energjia e konsumuar drejtpërdrejt përpara pikës së matjes, e kaluar në depozitim ose e llogaritur për një përdorim tjetër nuk përfshihet përsëri në sasinë që ndahet. Kur një anëtar përfiton nëpërmjet disa pikave matëse, pjesa e tij shpërndahet ndërmjet këtyre pikave sipas mënyrës së regjistruar të ndarjes.

Neni 5

Ndarja fikse

Në ndarjen fikse, çdo anëtari i caktohet paraprakisht një përqindje e energjisë së disponueshme. Përqindjet e të gjithë anëtarëve së bashku përbëjnë të gjithë sasinë e destinuar për ndarje dhe mbeten të pandryshuara gjatë periudhës përkatëse.

Në çdo interval, pjesa e anëtarit përcaktohet sipas përqindjes së tij. Për mbulimin e konsumit i njihet vetëm sasia që mund të përdorë brenda atij intervali. Pjesa që tejkalon konsumin e tij evidentohet veçmas si energji e papërdorur dhe nuk u rishpërndahet automatikisht anëtarëve të tjerë.

Neni 6

Ndarja dinamike

Në ndarjen dinamike, energjia shpërndahet sipas konsumit të matur të secilit anëtar në të njëjtin interval. Anëtari me konsum më të lartë merr një pjesë përkatësisht më të madhe të energjisë së disponueshme, ndërsa anëtari pa konsum nuk përfiton energji për atë interval.

Kur energjia nuk mjafton për të mbuluar të gjithë konsumin, ajo ndahet në përpjesëtim me konsumin e secilit anëtar. Kur energjia është e mjaftueshme, secilit i mbulohet konsumi dhe sasia e mbetur evidentohet si energji e pandarë. Pjesët e anëtarëve përcaktohen rishtazi për çdo interval.

Neni 7

Ndarja hibride

Në ndarjen hibride, një pjesë e energjisë ndahet sipas përqindjeve të paracaktuara, ndërsa pjesa tjetër ndahet sipas konsumit të matur. Pjesa e destinuar për ndarje fikse dhe përqindjet përkatëse përcaktohen përpara fillimit të zbatimit.

Fillimisht, çdo anëtari i ndahet pjesa fikse deri në masën e konsumit të tij. Më pas, energjia e mbetur, përfshirë pjesët fikse të papërdorura, u ndahet anëtarëve në përpjesëtim me konsumin që u ka mbetur ende i pambuluar. Energjia që mbetet pasi është mbuluar konsumi i të gjithë anëtarëve evidentohet si energji e pandarë.

Neni 8

Llogaritja dhe pasqyrimi i rezultateve

Operatori përkatës i rrjetit kryen llogaritjen sipas metodës, pikave matëse dhe përqindjeve të regjistruara. Ndryshimet zbatohen nga periudha e ardhshme e faturimit, pas kontrollit dhe

konfirmimit të tyre. Kur mungojnë të dhënat e matjes, ato nuk trajtohen automatikisht si konsum ose prodhim zero, por plotësohen sipas vlerave referuese apo kodit te matjes.
Për çdo anëtar pasqyrohen veçmas konsumi i matur, energjia e përfituar nga ndarja dhe konsumi që mbetet për t'u mbuluar nga furnizuesi. Rezultatet e intervaleve mblidhen për periudhën e faturimit, pa kompensuar prodhimin e një intervali me konsumin e një intervali tjetër. Energjia e pandarë evidentohet veçmas dhe nuk llogaritet si energji e konsumuar nga anëtarët. Kur korrigjohen matjet, rillogaritet ndarja për intervalet e prekura, duke ruajtur metodën dhe përqindjet që ishin të vlefshme në atë kohë.

Neni 9

Pasqyrimi në faturë

Operatori i përcjell furnizuesit sasitë e konsumit, energjinë e ndarë dhe tepricat për çdo pikë matëse të anëtarëve të KER-it .
Furnizuesi pasqyron në faturën individuale energjinë e përfituar nga KER-i, duke e dalluar nga energjia e furnizuar prej tij, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për informacionin minimal që duhet të përmbajë fatura e energjisë elektrike.
Faturimi dhe kompensimi duhet të jenë të saktë, të qartë dhe të verifikueshëm.

Neni 10

Tarifat e rrjetit

1. Për energjinë elektrike të ndarë ndërmjet anëtarëve të KER-it zbatohen tarifat e përdorimit të rrjetit, të miratuara nga ERE-ja, në përputhje me nivelin e tensionit dhe shërbimet e rrjetit të përdorura.
2. Llogaritja dhe aplikimi i tarifave kryhen mbi bazën e sasive të energjisë elektrike të ndarë, sipas të dhënave të matjes dhe rezultateve të konfirmuara nga operatori përkatës i rrjetit.
3. Për të njëjtën sasi energjie elektrike nuk aplikohet më shumë se një herë e njëjta tarifë për të njëjtin shërbim të përdorimit të rrjetit.
4. Tarifat e zbatueshme dhe mënyra e aplikimit të tyre përditësohen në përputhje me vendimet për tarifa në fuqi të ERE-s.

Neni 11

Tepricat dhe përfitimet financiare

Energjia që mbetet pas ndarjes evidentohet veçmas. Kur shitet ose kompensohet, përfitimi financiar ndahet sipas mënyrës së përcaktuar paraprakisht nga KER-i dhe kushteve të zbatueshme. Përqindjet e ndarjes së energjisë nuk përcaktojnë automatikisht ndarjen e të ardhurave nga tepricat.

Neni 12

Korrigjimi i faturimit dhe kompensimit

Kur operatori i rrjetit korrigjon të dhënat e matjes ose ndarjes, furnizuesi pasqyron ndryshimet përkatëse në faturim dhe kompensim, ne faturen sistemuese. Kompensimi mund të pezullohet përkohësisht vetëm kur mungojnë të dhënat zyrtare ose ka mospërputhje të te dhenave të konfirmuara nga operatori i rrjetit.

Neni 13

Ndërrimi i furnizuesit

Kur anëtari ndërron furnizuesin, faturimi dhe kompensimi përmbyllen deri në datën kur ndryshimi bëhet efektiv, sipas matjeve zyrtare, duke shmangur mbivendosjen ose lënien jashtë të sasive përkatëse.

Neni 14

Dispozita përfundimtare

Operatori përkatës i rrjetit, furnizuesit dhe KER-et zbatojnë këtë metodologji, secili sipas përgjegjësive përkatëse, duke siguruar saktësinë e ndarjes së energjisë dhe pasqyrimin e saj financiar.

Çështjet që nuk parashikohen shprehimisht në këtë metodologji trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, kodet dhe aktet e miratuara nga ERE-ja. Paqartësitë lidhur me zbatimin e saj i paraqiten ERE-së për shqyrtim.

Neni 15

Ndryshimet e metodologjisë

Ndryshimet dhe shtesat në këtë metodologji miratohen me vendim të ERE-së, sipas procedurave të zbatueshme. Propozimet për ndryshim duhet të jenë të arsyetuara dhe të shpjegojnë ndikimin në ndarjen e energjisë dhe në përfitimet financiare të anëtarëve. Ndryshimet zbatohen për periudhat pas datës së përcaktuar në vendimin përkatës. Ato nuk ndryshojnë ndarjet e përfunduara për periudhat e mëparshme, pa cenuar korrigjimin e gabimeve të matjes, llogaritjes ose faturimit.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Kjo metodologji hyn në fuqipas publikimit në fletoren zyrtare.. Data e fillimit të zbatimit të saj, si dhe periudha përgatitore, kur është e nevojshme, përcaktohen me vendim të Bordit të ERE-s.